

TLAS



SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 2 2010



Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian. Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) dhe asgjë në këtë botim, në asnjë rrethanë, nuk do të vlerësohet si pasqyrim i pozicionit të Bashkimit Europian.

RITJA E AKSESIT NE DREJTESI E GRUPEVE VULNERALE

Aktualisht procesi i reformes ligjore dhe institucionale nuk po i kushton vemendjen e duhur Aksesit ne Drejtësi te qytetareve dhe vecanerisht grupeve ne nevojë. Fakti qe strukturat e parashikuara ne funksion te zbatimit te Ligjit te Ndihmës Juridike, sic është Komisioni i Ndihmës Juridike, nuk arriten te jenë funksionale mbas prillit 2009 si edhe ende sot jemi ne fazën e propozimeve tregon se ne kushtet edhe te Integritimit dhe Asociimit sigurisht që duhen bërë hapa me te shpejta. Dihet që ne kushtet e mungesës së zbatimit të këtij ligji favorizues, njerëzit në nevojë janë të dekurajuar për të ndjekur të drejtat që u takojnë përmes gjyqësorit, dhe numri i të varfërve që janë objekt i gjykimeve të padrejta tashmë është i konsiderueshëm. Në këto kushte sigurisht që organizatat jo fitim prurëse që ofrojnë ndihmë ligjore falas në cështje

civile apo penale kanë qënë dhe mbeten domosdoshmëri për grupet vulnerabël.

Projekti i paraqitur nga TLAS në Komisionin European “ Rritja e Aksesit në Drejtësi të grupeve në nevojë” synon të forcojë përgjegjësinë dhe transparencën e Qeverisë Shqiptare për t'ju siguruar të varfërve dhe individëve të marginalizuar, përdorimin e sistemit ligjor : gjykatat, strukturat legjislative dhe ekzekutive të mbrojnë më mirë të drejtat e njeriut të luftojnë diskriminimin dhe të adresojnë cështjet



Seminar me OJF ROME Elbasan

themelore ligjore bazë që ju përkasin çështjeve civile. Aktivitetet e projektit synojnë të udhëheqin zbatimin e ligjit në mënyrë efektive dhe të barabartë për të gjithë, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, të influencojë në amendimin e ligjeve ekzistuese dhe vecanërisht në ligjin për "Ndihmën Ekonomike e Shërbimet Sociale". Konkretisht një nga komponentët e përmirësimit të ligjit është që të adresojë më mirë në të ardhmen problemet me të cilat përballen familjet e komunitetit Rome, të dënuarit në Institucionet e Vuajtjes së Dënimit por që plotësojnë kushtet e mungesës



Ne komunitetin ROM Rapisht, Elbasan

së të ardhurave ekonomike në qarqet e Tiranës, Elbasanit, Fierit, Durrësit dhe Lezhës. Edhe pse secili grup i përmëndur më sipër ka problemet e veta ligjore specifike një element i varfërisë, i pa aftësisë, i papunësisë, i mungesës së arsimit, i përkatësisë etnike, mbetet i përbashkët dhe i përjashton shpesh nga programet shtetërore të ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore.

Projekti: Rritja e Aksesit në Drejtësi për Grupet Vulnerabël

Financues: Komisioni Europian (Instrumenti European për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut)

Zbatues: Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Grupet në nevojë që do të përfitojnë nga projekti janë:

- * Komuniteti Rom në Tiranë, Elbasan, Durrës, Fier dhe Lezhë;
- * Të burgosurit vulnerabël në Tiranë, Elbasan, Durrës, Fier dhe

Lezhë¹;

- * Të tjerë individë të marginalizuar në të 5 rajonet;

- * Anëtarët e stafit dhe të komunitetit të NGO' ve me bazë përfituesit e përmëndur më sipër;

- * Punonjësit e administrates shtetërore që punojnë në sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe shërbime shoqërore në të 5 qarqet;

Ky projekt ka si objektiv kryesor rritjen e aksesit në drejtësi për grupet vulnerabël, duke kontribuar në zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë, shtetit ligjor dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

¹ Këto distrikte kanë komunitetet më të koncentruara të Romëve, duke përfshirë dhe qytetet e vogla në këto qarqe si Peqini, Rogozhina, Lushnja, Fushe Kruja. Kruja, etj. Gjithashtu Burgjet e Rogozhinës, Peqinit, Lezhës dhe Tiranës që kanë një numër të konsiderueshëm të burgosurish.



Seminar me OJF Lezhe



Seminar me OJF ROME ne Fushe Kruje

Kohëzgjatja e Projektit	<18 muaj> 01. 01. 2010 – 30.06.2011
Objektivat	1. Ofrimi i shërbimeve ligjore falas për grupet vulnerable, përfshirë dhe të dënuarit e varfër që vuajnë dënimin në IEVP në qarqet Tiranë, Lezhë, Elbasan, Durrës dhe Fier.² 2. Ndërgjegjesim i komunitetit vulnerabël në qarqet Tiranë, Elbasan, Fier, Durrës dhe Lezhë. 3. Rritja e përfshirjes sociale së familjeve dhe individëve vulnerabël përmes përmirësimit të Legjislacionit “Për Ndihmën Ekonomike dhe Përkujdesjen Sociale”.
Target grupet e synuara	Komuniteti Rom, të dënuarit vulnerabël që mund të përfitojnë nga Shërbimi i Provës, familje dhe individë të tjerë të varfër, organizatat me bazë komunitare dhe administratorët lokalë të ndihmës ekonomike në qarqet Tiranë, Lezhë, Durrës, Elbasan dhe Fier.
Aktivitetet Kryesore	Për objektivin e parë: a. Përfaqësimi në Gjykatë i 260 ceshtjeve nga të cilat: * 110 raste janë për të dënuarit që përfitojnë nga dënimet alternative * 70 raste janë për ceshtje të tjera civile b. Përfaqësimi në administratën shtetërore i 70 ceshtjeve që mund të zgjidhen me rrugë administrative c. Shërbim “clinics” për 306 ceshtje, përfituesit e të cileve kanë nevojë për këshillime dhe përpilime të dokumentave ligjore Për objektivin e dytë: * Organizimi i 18 vizitave dhe takimeve dhe shërbimeve ligjore “mobile” respektivisht: 6 në Tiranë, 3 në Fier, 3 në Durrës, 3 në Elbasan dhe 3 në Lezhë. * Organizimi i 5 seminareve me Organizatat me bazë komunitare, përfaqësuese të grupeve të synuara në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier dhe Lezhë. * Organizimi i 5 seminareve me administratorët e Ndihmës Ekonomike në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier dhe Lezhë. Për objektivin e tretë: * Ngritja e grupit të ekspertëve për të draftuar ndryshimet në legjislacionin ekzistues “Mbi ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale” * 20 tryeza e pune për draftimin e ndryshimeve * 2 tryeza të rrumbullakta për prezantimin e draftit fillestar dhe atë final me grupet e interesit.

2 Në qarqet e zgjedhura përfshihen IEVP në Rrogozhinë, Peqin, Fushë Krujë, Jordan Misja, Ali Demi, Vaqarri në Tiranë dhe Lezha.

Kontrata e Grantit me Komisionin European u nënshkrua në datën 14. 12. 2009 dhe ka hyrë në fuqi më 01. 01. 2010.

VIZITAT NE INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TE VENDIMEVE PENALE

Pas marrjes së listave përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, avokatët e TLAS me mbështetjen dhe të koordinаторit të caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, do të:

- * Vizitojnë të gjitha IEVP e targetuara
- * Takojnë të dënuarit që i plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga dënimet alternative
- * Aksesojnë dosjet personale të të dënuarve të përzgjedhur
- * Plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për përfaqësimin e çështjes në gjykatë
- * Zhvillojnë aktivitete ndërgjegjësimi ligjor në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, për t'i informuar të dënuarit për të drejtat dhe si mund të përfitojnë nga dënimet alterantive dhe shërbimi i provës.
- * Përfaqësojnë të dënuarit në

gjykatat e juridiksionit përkatës të IEVP 've që janë objekt i këtij projekti.

Trajtimi me procedura gjyqësore i 110 çështjeve të personave vulnerabël që vuajnë dënimin në IEVP e qarqeve te targetuara eshte vetëm një pjesë e projektit që TLAS do të zbatojë me grantin e miratuar nga Komisioni European.

Përfaqësimi me sukses i këtij projekti do të ketë ndikim në uljen e numrit të individëve të dënuar



Seminar me OJF ROME ne Fushe Kruje



Seminar me OJF ROME ne Lushnje

me vendime penale të formës së prerë që vuajnë dënimet e tyre në IEVP, duke ulur mbipopullimin në këto institucione dhe rritur efektivitetin e parandalimit të krimit sepse personat që do të përfitojnë nga dënimet alternative, do të integrohen më mirë në shoqëri, do t'i nënshtrohen më mirë rehabilitimit njerëzor dhe profesional.

Raimonda BOZO
Drejtoresh Ekzekutive e TLAS



PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT TË DËNIMIT ME BURGIM (DËNIMET ALTERNATIVE) DHE ROLI I SHËRBITIT TË PROVËS

Një nga ndryshimet ligjore më të rëndësishme është edhe ndryshimi i Kodit Penal përsa i përket dënimeve alternative pra zëvendësimi i dënimit me burgim me një dënim më të lehtë sipas kushteve të përcaktuara në ligj dhe Ligji për krijimin e Institucionit të Shërbimit të Provës.

Neni 59 i Kodit penal në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim parashikon se:

Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të

sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

Afati i provës është 18 muaj deri në 5 vjet.

Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet, siç është urdhëruar nga gjyka-



ta, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit."

Pra me qëllim për të arritur një riedukim sa më të shpejtë dhe për të bërë të mundur përshtatjen sa më të shpejtë në jetën ekonomike dhe sociale të të dënuarve, ligji rregullon një pjesë mjaft delikate të shoqërisë.

Një tjetër dënim alternativ është "Qëndrimi në Shtëpi", ligji para-

shikon se:

Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.
- b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të.
- c) Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.
- ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paaftë nga ana shëndetësore.
- d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevojë të dokumentu-



ara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësive familjare.

Gjykata mund të lejojë personat e dënuar me qëndrim në shtëpi të largohen nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, për të cilat shërbimi i provës është dakord.

Puna në interes publik dhe kriteret për tu aplikuar:

Kushti kryesor për të përfituar pezullimin e dënimit me burgim duke kryer një punë në interes publik është dënimi i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 1 vit. Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë.”.

“Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të



mbajë kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë.”.

“Nëse i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo shkel kushtet ose



detyrimet e tjera, të vendosura nga gjykata, prokurori informon menjëherë gjykatën.

Një pjesë të rëndësishme në këtë proces ka Institucioni i Shërbimit të Provës pasi është ai i cili mbikqyr të gjithë veprimtarinë e të dënuarve të cilët përfitojnë nga dënimet alternative.

Personat të cilët kanë përfituar nga ky ligj kanë disa detyrime, kështu ai është i detyruar që gjatë kohës së provës të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi shërbimin e

provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata si dhe të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit".

Sipas ligjit konsiderohet shkelje e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës:

Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale, gjykata mund të ndryshojë detyrimet që ka vendosur, ta zëvendësojë dënimin e dhënë me një dënim tjetër, apo ta revokojë, tërësisht ose pjesërisht, vendimin e pezullimit.

Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, shkel kushtet ose detyrimet që i janë vendosur, shërbimi i provës i raporton menjëherë prokurorit.

Për shkelje të lehta dhe për herë të parë të kushteve ose të detyrimeve që i janë vendosur nga gjykata, prokurori ka të drejtë të japë paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen personale të të dënuarit.

Për shkelje të rënda ose të

përsëritura, prokurori i kërkon gjykatës ndryshimin e detyrimit të vendosur, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër, ose revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg.”.

Këto ishin disa nga ndryshimet ligjore më të rëndësishme në lidhje me krijimin e këtij Instituti të ri në vendin tonë sidomos përsa i përket një teme mjaft të ndjeshme sic është sistemi penitenciar.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS

HISTORI E VËRTETË

Pranë Zyrës tonë u paraqit një klient i cili jetonte në qytetin e Tiranës me initiale N.V. Pasi kishte marrë dijeni për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë, ai u paraqit duke kërkuar konsulencë ligjore për problemin e tij i cili konsistonte në gabimin që ishte bërë në regjistrimin e datës së lindjes së tij.

Pasi u krye një intervistë me të u identifikuan problemet e tij. Nga



intervista u konstatua se klienti N.V për një periudhë të gjatë kohe kishte jetuar në qytetin e Mirditës ku edhe kishte lindur.

Para 5 vjetësh kishte transferuar gjëndjen civile nga qyteti i Mirditës drejt qytetit të Tiranës.

Pasi ishte transferuar në qytetin e Tiranës ishte drejtuar në Zyrat e Gjëndjes Civile për tu pajisur me çertifikatë të cilën do ta përdorte për të marrë pashaportë.

Në momentin që ishte paraqitur në gjëndjen civile kishte konstatuar se data e lindjes së tij nuk korrespondonte me datën në të cilën ai kishte lindur, pasi të gjithë dokumentat që ai dispononte

që nga fëmijëria dhe të gjithë dokumentat e tjerë të shkollës dhe të punës ishin me datën në të cilën ai kishte lindur.

Nderkohe që në aktin e lindjes i ishte regjistruar si datë lindjeje një datë tjetër.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin se kjo çështje mund të ndiqej nga avokatet e zyrës tonë por vetëm përsa i përket përpilimit të dokumentave të nevojshëm për gjyq dhe të gjithë dokumentave të tjerë që do të kërkoreshin nga gjykata gjatë zhvillimit të procesit. Vete ky proces kishte një specifikë pasi gjykimi nuk mund të zhvillohej në qytetin e Tiranës por duhet të zhvillohej në qytetin në të cilin ishte mbajtur akti i lindjes para 50 vjetësh, pra në qytetin e Mirditës.

U shqyrtua rasti dhe u mendua që të përpilohej një padi me objekt "Deklarimi i pasaktësisë së rubrikës "datëlindja" e aktit të lindjes së klientit N.V, përsa i përket rubrikës së datës së lindjes". Klienti N.V pretendonte se



deklarimi nga ana e te afërme për lindjen e tij ishte bërë i saktë por punonjësit e gjendjes civile kryesisht nga neglizhencia e kishin lënë pas dore duke mos i kryer të gjitha procedurat në momentin e deklarimit por në një moment të mëvonshëm duke sjellë edhe gabimin në rubrikën e datëlindjes.

Neni 39/3 i ligjit “Per Gjendjen Civile” shprehet se “Shtetasi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, si dhe çdo person tjetër qe pretendon se i është cënuar një e drejtë ose është privuar nga pasoja juridike të caktuara, pretendimet për pavlefshmëri, pasaktësi e falsitet mund t'i parashtrojnë vetëm gjyqësisht, duke thirrur si të paditur zyrën e gjendjes civile, ku është mbajtur akti dhe deklaruesin, kur nuk është vetë paditës.”

Në këtë rast pretendimet e klientit N.V per pasaktësi vërtetoheshin plotësisht pasi të gjithë dokumentat që ai dispononte kishin datëlindjen e saktë të tij.

U depozitua kërkesë padia në gjykatë dhe u procedua me hapat e mëtejshëm, ku u zhvilluan disa seanca gjyqësore, gjatë kësaj kohe vazhdimisht çështja u ndoq nga avokati i caktuar duke përgatitur dokumentacionin ligjor në lidhje me çështjen dhe duke dhënë konsulenca të vazhdueshme për çështjen. Gjykata arriti në përfundimin se klienti N.V kishte të drejtë në kërkimin e tij duke i njohur në këtë mënyrë të drejtën e tij për të korrigjuar pasaktësitë e bëra në aktin e lindjes së mbajtur në qytetin e Mirditës.





Mbas një pune të gjatë duke vlerësuar dhe kontributin e madh të Zyrës për Shërbimin Ligjor Falas u arrit në përfundimin e dëshiruar nga klienti N.V.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS

HISTORI E VËRTETË

Pranë Zyrës tonë u paraqit një klient i cili jetonte në qytetin e Tiranës me initiale Z.M. Pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë, ajo u paraqit duke kërkuar mbrojtje ligjore për të drejtat e saj që i takonin me ligj por që ajo nuk mund ti gëzonte pikërisht për shkak të veprimeve të paligjshme të kryera nga persona të tjerë që kishin cënuar të drejtën e saj të pronësisë.

Pasi u krye një intervistë me të u identifikuan problemet e saj. Nga intervista u konstatua se klientja Z.M kishte trashëguar nga bashkëshorti i saj një tokë e cila ishte e zënë nga persona të tjerë në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin.

Sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi klientja ishte pronare e një siperfaqe toke sipas ligjit 7501 dt 19/07/1991. Këto siperfaqe nuk shfrytëzoheshin dot

prej saj dhe familjes së saj pasi ishin të zaptuara nga persona të tjerë.

Personi e kishte zaptuar në mënyrë të padrejtë tokën e klientes, duke vepruar në mënyrë të paligjshme, duke bërë kështu që ajo si pronare e ligjshme të mos ushtronte dot tagrat e pronarit, posedimin dhe gëzimin e pronës, por edhe sendi në pronësi dëmtohej pasi në këtë sipërfaqe ishte ndërtuar një objekt. Klientja Z.M kërkonte ti dorëzonin sendin, tokën e saj duke i lejuar kështu të ushtronte të drejtat e saj si pronar i ligjshëm dhe duke i dhënë fund posedimit të paligjshëm të pronës prej personave të tjerë nëpërmjet lirimit të tokës nga zaptimi.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin se kjo çështje mund të ndiqej nga avokatët e zyrës tonë.

U shqyrtua rasti dhe u mendua që të përpilohej një padi me objekt "Dorëzimin e sendit duke liruar truallin e zënë me

ndërtim". Bazuar pikërisht në Kodin Civil i cili në nenin 296 shprehet se "Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës. Këtë të drejtë e ka edhe çdo bashkëpronar për sendin e përbashkët, me qëllim që ai t'u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve."

U mendua që fillimisht të mblidheshin të gjithë materialet e nevojshme për këtë gjyq.

U depozitua kërkesë padia në gjykatë dhe u procedua me hapat e mëtejshëm, ku u zhvilluan disa seanca gjyqësore, gjatë kësaj kohe vazhdimisht





NDJEKJA E RRUGËS ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE NË PËRFITIMIN E TË DREJTËS SË PENSIONIT

çështja u ndoq nga avokati i caktuar duke përgatitur dokumentacionin ligjor në lidhje me çështjen. Gjykata arriti në përfundimin se klientja Z.M kishte të drejtë në kërkimin e saj duke i njohur në këtë mënyrë të drejtën për të liruar pronën e saj të zaptuar në mënyrë të paligjshme nga persona të tjerë".

Mbas një pune të gjatë duke vlerësuar dhe kontributin e madh të Zyrës për Shërbimin Ligjor Falas u arrit në përfundimin e dëshiruar nga klienti Z.M.

ADRIAN SHEGA, Avokat, TLAS

Pranë TLAS janë adresuar mjaft persona të cilët kanë aplikuar pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Mjaft prej tyre kanë patur parregullsi të dokumentave të paraqitura për të kërkuar të drejtën e pensionit pranë ISSH. Shumë prej aplikuesve janë persona, të cilët nuk kanë asnjë të ardhur tjetër financiare dhe pensioni i pleqërisë i plotë apo i pjesshëm dhe i invaliditetit është e vetmja mundësi ekonomike për ta dhe familjet e tyre.

Si një parim i së drejtës, konfliktet fillimisht duhet të zgjidhen administrativisht nëpërmjet organeve administrative, të cilët kanë detyrimin ligjor për të garantuar të drejtën e personit. Procedurat e përfitimit të pensionit të pleqërisë gjejnë rregullim në

ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore".

Aplikantët i drejtohen fillimisht ISSH kur ata plotësojnë kushtet për të përfituar pensionin e pleqërisë, nëse kanë plotësuar vitet e vjetërsisë për punë dhe moshën. Aplikantët fillimisht duhet të bëjnë aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Ky institucion është shkalla e parë që shqyrton kërkesat e individëve nëse ata kanë të drejtën për të përfituar pensionin e pleqërisë. Procesi administrativ, apelimi rregullohen hollësisht në Kodin e Procedurave Administrative. Pasi DRSSH nxjerr vendimin e saj, nëse kërkuesi nuk pranon këtë vendim atëherë mund t'i drejtohet duke e apeluar tek Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore, e cila duhet të japë një vendim përfundimtar administrativisht lidhur me pretendimin e personave, bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Nëse përsëri kërkuesi nuk është dakord me këtë vendim

atëherë atij i lind e drejta brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit prej DPSSH ose prej ditës së marrjes dijeni për këtë vendim t'i drejtohet nëpërmjet padisë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për të kërkuar vendosjen përfundimtare për kërkesën e personit për përfitimin e pensionit të pleqërisë, bazuar në Kodin e Procedurës Civile.

Në pjesën më të madhe të rastevë të klientëve të paraqitur, pretendimet e tyre janë adresuar në gjykatën e rrethit gjyqësor me objekt kundërshtimin e vendimit të ISSH dhe pagimin e pensionit





të plotë të pleqërisë prej ditës së lindjes së tij duke patur si shkak se ISSH ka mangësi të madhe dhe keqadministrim të regjistrave dhe arkivave të veta. Shpesh herë të dhënat në arkiva mungojnë apo nuk janë të plota, duke cuar në mosnjohjen e viteve të punës të kërkuesit dhe si rrjedhojë mospërfitimin e pensionit të pleqërisë. Ky pretendim nuk është aspak i drejtë dhe i ligjshëm, pasi kërkuesi penalizohet për mbajtjen e një dokumentacioni, për të cilin ai nuk ka qënë përgjegjës. Me shpjegimin se të dhënat e personit nuk gjenden

apo dokumentacioni nuk ekziston, ka si pasojë refuzimin e kërkesës për pension të individit, që sjell si pasojë faktin, që personit të mos i paguhet pensioni, kur detyrimi i tij i vetëm ka qënë vetëm mirëmbajtja e librezës së punës. Libreza e punës është një dokument zyrtar, ku shënohen e vulosen vitet e punës gjatë të cilave ka punuar personi. Duke qënë se është një dokument zyrtar, ai do të bëhet i papërdorshëm vetëm nëse do të konsiderohet i fallsifikuar sipas Kodit të Procedurës Civile dhe për atë kohë sa ISSH nuk e kundërshton këtë dhe as nuk e godet si të fallsifikuar, atëherë nuk ka arsye pse të mos pranohen të dhënat e përmbajtura në të.

Ceshtja do të ndryshonte dhe do të kishim një qëndrim ndryshe nëse personi nuk është pajisur me librezë pune, e ka humbur atë apo e ka bërë të papërdorshme. Në këtë rast verifikimi i vjetërsisë në punë ndërlikohet dhe procedura që do të ndiqet është vetëm gjyqësore dhe në gjykatë nuk do të bëhet kundër-

shtim i vendimeve administrative të ISSH. Sipas Kodit të Procedurës Civile do të ndiqet rruga e vertetimit të faktit të viteve të punës dhe se si do të realizohej kjo atëhere varet nga përpjekjet e personit për të gjetur vërtetime (prova shkresore), për të vërtetuar se ai ka punuar në një vend pune apo dhe dëshmitë e kolegëve të tij, të cilët njihen si pensionistë prej ISSH dhe janë të gatshëm të dëshmojnë përpara gjykatës se e njohin kërkuesin si kolegun e tyre. Të gjitha provat në tërësi bindin gjykatën, që nëpërmjet vendimit të saj vërteton se një person ka punuar në një vend pune për një kohë të caktuar. Ky vendim i bashkangjitet dosjes së aplikimit të personit dhe bën që atij t'i njihet e drejta për të përfituar pension pleqërie.

Duke iu rikthyer njohjes së kësaj të drejte në rugë administrative, kohët e fundit ISSH ka qarkulluar një vendim nr. 13 dt 24.12.2009, të miratuar nga Këshilli Administrativ i ISSH në zbatim të rregullores nr. 1 dt 21.12.2008 "Për caktimin, administrimin dhe

pagesat e pensioneve" të ISSH duke rregulluar një sërë situatash për të cilat më parë angazhohej gjykata për zgjidhjen e tyre. Kështu, ky vendim zgjidh administrativisht situatat, kur kërkuesi ka shkurtime në emrin e vet apo të atësisë, ka ndryshime në mbiemër apo atësia është e ngatërruar me mbiemrin dhe në varësi të dokumentacionit provues të plotë, ISSH i njeh kërkuesit të drejtën e pensionit pa e drejtuar atë për t'i dhënë zgjidhje problemit nëpërmjet gjykatës. Ky vendim i ISSH është një veprim shumë lehtësues dhe favorizues ndaj kërkuesve,



të cilët humbisnin shumë kohë dhe përballeshin me zvarritje të mëdha të proceseve gjyqësore, vetëm për të korrigjuar me vendim gjykatë një gërmë në emrin e tyre. Rastet e pensioneve zënë një peshë shumë të madhe në numrin e klientëve, të cilët i drejtohen TLAS-it. Avokatët e TLAS janë tepër të angazhuar në dhenien zgjidhje të këtyre rasteve duke marrë parasysh fillimisht rrugën më të lehtë atë administrative dhe nëse do të jenë kushtet e përcaktuar në ligj, rasti mund të kalojë për gjykim pranë gjykatës.

Anisa Haxhia
Avokate/Keshilltare Paraligjore
TLAS



HISTORI E VËRTETË, RASTI I KLIENTES K.L

Klientja K.L u paraqit shumë shqetësuar pranë TLAS, pasi bashkëshorti i saj, më të cilin kishte bashkëjetuar prej 10 vitesh e kishte braktisur. Cifti nuk kishte patur martesë ligjore, por vetëm bashkëjetesën faktike. Nga kjo lidhje ata kanë dhe një vajzë 5 vjece shumë të bukur autike. Ish-bashkëshorti dhe të afërmit e tij gjithmonë e më tepër shfaqnin indiferencë dhe mosinteretim për gruan dhe vajzën e tij. Për shkak të marrëdhënieve të vështira mes ciftit, klientja vendosi të largohet në një banesë tjetër. Ajo jeton në një dhomë të vogël në shtëpinë e familjes së motrës së saj, dhe fle në të njëjtin krevat me vajzën. Për shkak të gjëndjes së vështirë shëndetësore të vajzës, klientja në asnjë moment nuk mund ta lërë atë vetëm, sepse ajo kërkon vëmendje dhe përkujdesje të vazhdueshme. Kjo situatë pengon që klientja të

përpiqet të punësohet diku dhe të ketë mundësi të nxjerrë të ardhura.

Kur klientja u interesua pranë TLAS ajo nuk kishte asnjë lloj përkrahje, përvec ndihmës ekonomike që ajo e përfitonte për shkak të gjëndjes shëndetësore të vajzës dhe të ardhurat e ndihmës shpenzoheshin vetëm për ilacet e vajzes.

Avokati i TLAS pasi e intervistoi klienten mendoj t'i drejtohej gjykatës më kërkesë padi kundër ish-bashkëshortit të klientes, në mënyrë që të përcaktohej përgjegjësia prinderore për rritjen e fëmijës dhe caktimin e detyrimit ushqimor të babait ndaj fëmijës së klientes, pra pagimin e një shume parash për mbulimin e shpenzimeve mujore për vajzën. Cështja po gjykohet në gjykatën e Tiranës sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Familjes dhe Kodit të Procedurës Civile. Kështu sipas Kodit të Familjes, nenit 192 të Kodit të Familjes "Detyrimin për ushqim e kanë ... prindërit ndaj fëmijëve të tyre" dhe sipas nenit 197 të Kodit të



Familjes "Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjetë të mjaftueshme për të jetuar". Ky rast është tepër i vështirë, pasi shoqërohet me kundërshtimet e ish-bashkëshortit të klientes dhe familjes së tij për pagimin e detyrimeve ndaj fëmijës së tij, me pretendimin se ai është i papunë dhe nuk ka të ardhura të mjaftueshme financiare. Gjykata duke marrë parasysh thëniet e palëve në proces, provat e paraqitura, raportin e psikologes, e cila harton raportin e detajuar psikologjik lidhur

me situatën e vajzës, kushtet e jetesës së prindërvë të saj, do të vendosë në favor të interesit më të lartë të fëmijës.

Ndërkohë që klientes po i zhvillohet procesi gjyqësor, avokati i TLAS kontaktoi disa herë me organizata partnere për t'i ofruar ndihmë të specializuar fëmijës së klientes, për trajtimin e rasteve të fëmijëve autik. Klientja u adresua te Caritas shqiptar, i cili pranoi ta ndihmonte vajzën e klientes. Avokati i TLAS e ndihmoi K.L për hartimin dhe mbledhjen e dokumentave të nevojshme, që do t'u adresohen nëpërmjet Caritas donatorëve

të mundshëm për t'i ofruar ndihmë kësaj fëmije.

Përveç kësaj përpjekjeje avokati kontaktoi me një kopësht fëmijësh në qytetin e Tiranës, që trajton fëmijë me probleme për ta sistemuar vajzën pranë këtij kopshti.

Rasti i kësaj kliente është tepër i ndërlikuar i ndikuar nga situata e vështirë shëndetësore e fëmijës, kushtet e vështira të jetesës dhe mosinteresimit të prindit ndaj ish-bashkëshortit dhe fëmijës.

Anisa Haxhia
Avokate/Keshilltare Paraligjore
TLAS



HISTORI E VERTETE RASTI I KLIENIT S.L

Për klientin S.L. u interesua i vëllai i tij pranë TLAS, sepse klienti është në gjëndje të vështirë shëndetësore dhe e ka të vështirë lëvizjen.

Klientit i është komunikuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë se atij i pezullohet pagesa e përfitimeve mujore të pensionit të pleqërisë, kjo për arsyen se ai duhet të paraqitej pranë DRSSH Tiranë për të sqaruar dhe saktësuar disa probleme që kishin dalë në lidhje me rillogaritjen e pensionit.

Sipas këtij akt pezullimi klienti iu drejtua Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, e cila i kthen përgjigje dhe e sqaron se thuhet se pensioni i pleqërisë i ndërpritet pas kontrollit nga audit i ISSH për arsyet se në dokumentacionin e vendit të punës, nuk figuron emri i klientit dhe sipas aktit të verifikimit të autoritetit të kontrollit rezulton se me

emrin e klientit në regjister ka ditë pune të ndryshme nga të dhënat e librezës së punës dhe se klienti ka punuar në një vend tjetër pune dhe jo në atë në të cilin ai pretendon apo ka të shënuar në librezën e punës.

Për këto arsye pensioni i tij rillogaritet dhe ai konsiderohet edhe si debitor për masën e pensionit të marrë padrejtësisht duke u detyruar të kthejë 50% të masës së pensionit të përfituar deri në atë moment.

Bazuar në këto përgjigje, klienti iu drejtua gjykatës me kërkesë padi, ku në objekt kerkoi shfuqizimin e aktit të rillogaritjes



së masës së pensionit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tirane dhe detyrimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore që të paguajë pensionin e plotë të pleqerisë prej datës së pezullimit të tij. Pretendimin e tij ai e bazoi në ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore", Neni 420 i Kodit Civil, dhe 153-154, që bëjnë fjalë për ngritjen e padisë në gjykatë sipas Kodit të Procedurës Civile. Argumentat e dhëna përpara gjykatës kanë të bëjnë me arsyetimin se rillogaritja e masës së pensionit nuk përmban karakter

administrativ, i cili mund të trajtohet sipas Kodit të Procedurave Administrative, por civile e rrjedhur prej marrëdhënies administrative të krijuar mes palëve. ISSH sipas ligjit bën llogaritjen, caktimin dhe pagimin e përfitimeve që rrjedhin prej ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore". Pavarësisht krijimit të një marrëdhënieje juridiko-private, ligji parashikon krijimin e marrëdhënies juridiko-administrative mes ISSH dhe individit, vetëm përsa i përket llogaritjes dhe caktimit të masës së pensionit, ku ISSH ka kompetencën që nëpërmjet procedurës administrative të llogarise dhe të caktojë përfitimin e pensionit për individin.

Marrëdhënia mes palëve, klientit dhe ISSH zhvillohet si marrëdhënie juridiko-civile. Vetëm fakti që ISSH ka nxjerrë një akt për rillogaritjen e përfitimit nuk është i mjaftueshëm për të konsideruar se mes palëve ka lindur një mosmarreveshje administrative dhe akti i nxjerrë prej institucionit të jetë i kundërshtueshëm gjyqësisht si akt ad-



ministrativ.

Klientit i lind mundësia t'i drejtohet gjykatës për shkak të mospërbushjes së detyrimit të mohuar prej ISSH. Ky detyrim i ISSH buron nga ligji dhe jo nga akti fillestar i caktimit të pensionit, pra mospërbushja e këtij detyrimi është e rrjedhur nga ligji. Marrëdhënia juridike civile rregullohet nga ligji nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore", i cili rregullon rrethanat e kësaj marrëdhënieje, sic është pagesa më pak e përfitimeve të caktuara.

Kjo do të thotë gjithashtu se ISSH nuk ka kompetencë rivleresimi. Ligji ka parashikuar vetëm caktimin dhe llogaritjen fillestare të pensionit dhe nuk parashikon mënyrën e zgjidhjes kur kushtet ndryshojnë duke mos parashikuar ndërprerjen e pensionit në mënyrë të njëanshme. Gjykata është i vetmi organ, i cili mund të përcaktojë ndërprerjen e pensionit.

Si rrjedhim rillogaritja e pensionit të klientit është një veprim i paligjshëm, që do të thotë se nuk parashikohet si i tillë nga ligji,



por ligji parashikon momentin fillestar të caktimit. "rillogaritja" dhe "pezullimi" i pagimit të pensionit të pleqërise janë të pabazuar në Ligjin nr. 7703 pasi në thelb kemi të bëjmë me "anullimin e një pensioni që vazhdon të paguhet" dhe jo me një kërkesë për të kërkuar përfitimin e pensionit.

Gjithashtu, klienti pretendon se mungesa e të dhënave të tij në regjistra në arkivë nuk ka përse ta penalizojë atë pasi nuk është ai personi përgjegjës, i cili ka patur për detyrë të kujdeset për

ato. Detyrimi i tij i vetëm është të mirëmbaje librezën e punës, si dokument zyrtar i verifikuar edhe prej ISSH dhe i rezultuar me të dhëna të sakta. Dokumenti i paraqitur nga ana e klientit, "libreze pune" perfaqëson një dokument zyrtar. Si i tillë ai mund të kundërshtohet vetëm "për fallsitet" sipas nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile.

Klienti paraqiti edhe dëshmitare ish-kolegët, të cilët kanë punuar me të dhe ishin të gatshëm të ndihmonin mikun e tyre në

gjykatë.

Gjykimi për problemin e klientit zgjati shumë muaj, dhe ishte tepër i debatueshëm dhe profesional. Gjykimi po shkon drejt përfundimit dhe vendimi është në favor të klientit, i cili shumë shpejt do të përfitojë pensionin e pleqërisë në të njëjtën masë si më parë.

Anisa Haxhia
Avokate/Keshilltare Paraligjore
TLAS



PROGRAMI I KREDIVE TË LEHTËSUARA NGA SHTETI – PJESË E PROGRAMIT TË BANESAVE ME KOSTO TË ULËT

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), ka përfshirë në punën e tij edhe ndihmën konkrete për plotësimin e dokumentacionit për familjet në nevojë, që dëshirojnë të aplikojnë për t'u përfshirë në Programin e Kredive të Lehtësuara nga Shteti, në kuadrin e Programit të Banesave me Kosto të Ulët, program i cili mundëson ndarjen e rreth 1000 kredive. Në këtë kuadër, Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social të Bashkisë së Tiranës, ka filluar zbatimin e këtij programi në vitin 2010 dhe për këtë ka nxjerrë njoftimet zyrtare në Zyrën e Informimit të Qytetarëve, në Njësitë Bashkiake të qytetit të Tiranës, për të gjithë qytetarët/familjet që kanë paraqitur pranë zyrave përkatëse në Bashki, kërkesën për strehim në Pro-

gramin e Banesave me Kosto të Ulët dhe që kanë nivelin e të ardhurave në kufijtë:

31 007 - 51 249 lekë (për familjet të përbëra nga 1- 2 persona)

41 865 – 65 964 lekë (për familjet të përbëra nga 2-3 persona)

54 153 – 84 035 lekë (për familjet të përbëra nga 3-4 persona)

68 585 – 107 142 lekë (për familjet të përbëra nga 4-6 persona)





Qytetarët mund të aplikojnë, për të përfituar nga trajtimi me Programin e Banesave me Kosto të Ulët sipas udhëzimit nr.6257, datë 02.09.2008 "Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti", të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve si dhe Ministrisë së Financave, me dhënien e rreth 1000 kredive.

Të gjithë qytetarët e interesuar për t'u trajtuar me këtë program, mund të dorëzojnë

dokumentacionin e kërkuar pranë Bashkisë së Tiranës, i cili shqyrtohet fillimisht nga Sektori i Strehimit në Drejtorinë e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social dhe pastaj vlerësohet nga Komisioni i Strehimit ngritur me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 08.11.2005 "Për miratimin e Komisionit të Strehimit" (i ndryshuar).

Më pas, është Këshilli Bashkiak i Tiranës si organ vendimarrës, i cili shqyrton dhe miraton listën e përfituesve për programin e kredive të lehtësuara nga shteti.

Sipas këtij programi, aktualisht, janë miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 23, datë 26.10.2009 për "Trajtimin e familjeve që përfitojnë nga projekti për subvencionimin e interesave të kredisë", 55 familje si dhe 90 familje me vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 7, datë 15.01.2010, lista emërore e të cilëve i është dërguar Bankës Kombëtare Tregtare.

Ndërsa familjet që figurojnë qiramarrës në banesat, pronë

e subjekteve të shpronësuar në bazë të udhëzimit nr. 6257, datë 02.09.2008 mbi " Përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti", (i ndryshuar), duhet të drejtohen pranë Entit Kombëtar të Banesave, pasi sipas pikës 1 të këtij udhëzimi do të paguajnë vetëm principalin e kredisë me interes 0%.

Familjet të cilat plotësojnë kriterin e të ardhurave të sipërcituar, duhet të plotësojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

1) Certifikatën e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare;

2) Vërtetimin për vendbanimin në bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;

3) Vërtetimin e të ardhurave neto të familjes;

4) Dokumentacionin përkatës nga punëdhënësi për detyrën

dhe të ardhurat e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;

5) Dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, kur njëri nga anëtarët e familjes është i vetëpunësuar;

6) Vërtetimin nga zyra e ndihmës dhe përkujdesit pranë bashkive, për anëtarët e familjes, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuara;

7) Vërtetimin nga zyra e punësimit e njësisë vendore për-



katëse, për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;

8) Vërtetimin nga organet e sigurimeve shoqërore, për personat në pension;

9) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponon në pronësi banesë a ndonjë mjedis, që mund të përdoret si e tillë;

10) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë

anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit;

11) Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës, se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;

12) Dokumentin zyrtar të celebrimit dhe certifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja;

13) Vendimin e gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara;

14) Vërtetimin përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit;

15) Vendimin e komisionit mjekësor të përcaktimit të verbërisë ose të komisionit mjekë-



sor të përcaktimit të aftësisë për punë, për individë me aftësi të kufizuara, që trajtohen sipas shkronjës "d" të nenit 5 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane".

16) Dokument që vërteton se familja jeton në shtëpi me ish pronarë

17) Dokument që vërteton se familja ka humbur shtëpinë në firmat piramidale.

18) Dokument që vërteton se familja ka mbetur e pastrehë për shkak të zbatimit të projekteve publike e ndërtimit të veprave me interes publik (shembje banesave informale, lirim objekteve me funksione publike)

19) Deklaratë personale e noterizuar ku përfshihen të gjitha pikat e mësipërme.

I gjithë dokumentacioni i dorëzuar pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social shqyrtohet

paraprakisht nga Sektori i Strehimit dhe pastaj nga Komisioni i Strehimit ngritur me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 08.11.2005 "Për miratimin e Komisionit të Strehimit" (i ndryshuar).

Ndër të gjithë aplikantët do të jenë fitues ata që kanë fituar pikët maksimale sipas sistemit të pikëzimit të miratuar me VKB nr. 51, datë 19.12.2008 për "Miratimin e sistemit të pikëzimit për bonusin e strehimit dhe sistemit të pikëzimit për subvencionimin e familjeve që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti".

Elvira Dervishi
Këshilltare e Programit, TLAS



HISTORI E VËRTETË

I. Sh. ka lindur kur babai i tij ishte në burg për çështje politike. Tani babai nuk jeton më, por trashëgimtarëve të tij u takon shpërblimi për shkak të statusit të të përndjekurit politik. Që I. Sh. të përfitonte pjesën e tij nga ky shpërblim, nga Ministria e Drejtësisë fillimisht kërkohet çelja e dëshmisë së trashëgimisë së babait të I. Sh. Problemi me të cilin ishte ndeshur I. Sh. ishte mungesa e dokumentacionit që vërtetonte atësinë e tij. Në Regjistrin Themeltar të Gjëndjes Civile, emri i babait ishte i saktë,



por nuk kishte dokument nga aktet që të vërtetonte në mënyrë ligjore atësinë.

I. Sh. u drejtua në Shërbimin Ligjor Falas Tiranë, për ta ndihmuar për ndjekjen e procedurave gjyqësore të çeljes së dëshmisë së trashëgimisë dhe në procesin e grumbullimit të këtij dokumentacioni, u zbulua që mungonte dokumenti për njohjen e atësisë së I. Sh. nga babai i tij. Sipas të dhënave të I., kur ai kishte lindur, babai i tij ishte në burg dhe martesë me nënën e tij nuk ishte bërë ende. Më vonë ishte bërë martesë dhe më tej edhe zgjidhja e martesës. Detyra e parë ishte gjetja e aktit të lindjes, për të verifikuar nëse ishte deklaruar atësia. Nga të dhënat e I. për adresën e nënës së tij, TLAS u interesua në Bashkinë e Tiranës, në arkiv, por nuk u gjet akti i tij i lindjes, në adresën e dhënë nga I.

Meqë nuk arritëm të gjenim aktin e lindjes, menduam të gjenim vendimin e zgjidhjes së martesës së prindërve të tij,

me shpresën që gjykata ishte shprehur për prindin që do përkujdesej për fëmijën (I. Sh.) dhe kështu të kishim prova për atësinë e fëmijës. Meqë I. Sh. nuk e dinte datën e zgjidhjes së martesës dhe as nëna e tij nuk e mbante mend, u interesuam në Njësinë Bashkiake Nr. 6, për të parë tek të dhënat e nënës së tij. Në fletën familjare aktuale të nënës së tij, nuk figuronte që djali i saj të kishte qënë ndonjëherë pjesë e familjes së nënës. Nga të dhënat për datën dhe vendimin e gjykatës për zgjidhjen e martesës, morëm në gjykatë një kopje të vendimit të zgjidhjes së martesës, por në këtë vendim gjykata nuk ishte shprehur për fëmijën (I. Sh.).

Meqë nuk kishte të dhëna për I. Sh. në gjëndjen familjare të nënës pas zgjidhjes së martesës, kontrolluam tek të dhënat familjare të nënës së tij, para martesës. Gjithashtu verifikuam që I. Sh. nuk figuronte në fletën familjare të nënës së tij para martesës, në të dy njësitë vendore, ku ajo kishte banuar,



si rezultat i transferimeve të njëpasnjëshme.

Nga gjithë këto kërkime, arritëm të gjejmë datën e martesës dhe njësinë vendore ku ishte lidhur martesa. Verifikuam aktin e martesës të prindërve të I. Sh., duke menduar se fëmija mund të kishte lindur para lidhjes së martesës dhe ishte bërë njohja e atësisë në momentin e lidhjes së martesës. Por as ky variant nuk rezultoi. Më tej, duke gjetur adresat e ndryshme të regjistrimit të nënës, mundëm të gjejmë njësinë vendore ku ishte mbajtur akti i lindjes së fëmijës. Në këtë akt lindje, deklaruesit ishin nëna



HISTORI E VËRTETË

Në qendrën e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) u paraqitën një ditë Sh. B. dhe I. K. Ata bashkëjetonin prej disa vitesh dhe si rezultat i kësaj bashkëjetese kishte lindur edhe një vajzë. Vajza 3 vjeçare, nuk ishte regjistruar ende në gjendjen civile, për shkak se Sh. B. dhe I. K. nuk dinin si duhet të vepronin dhe ku duhet të drejtoheshin. Për këtë arsye, fëmija kishte vështirësi për të marrë shërbimet sociale dhe shëndetësore, si të gjithë moshatarët e saj. Përveç regjistrimit të vajzës, ata donin të bënin edhe lidhjen e martesës.

dhe babai i fëmijës. Kështu pra, përfundimisht mundëm të gjenim dokumentin kryesor që vërtetonte atësinë e I. Sh.

Mbas grumbullimit të të gjithë çertifikatave të nevojshme të gjëndjes civile, realizuam çeljen e dëshmisë së trashëgimisë së I. Sh. Vendimi i gjykatës, provonte që I. Sh. ishte djali që trashëgon-te pjesën e tij, në të gjitha asetet e babait të tij të vdekur. Në këtë mënyrë, ai mundi të merrte pjesën e tij të dëmshpërblimit, si djali i një të përndjekuri politik.

Elvira Dervishi
Këshilltare e Programit, TLAS

Sh. B. dhe I. K. jo vetëm që nuk kishin dijeni për veprimet që duhet të kryheshin pranë zyrave të gjëndjes civile, por nuk kishin as mjetet e nevojshme financiare për të përballuar shpenzimet e kërkuara. Sh. B. është e papunë, kurse I. K. bën punë të rastit dhe me të ardhurat e pakta siguron me shumë vështirësi mbajtjen e familjes. Ata banojnë në një

barakë, në periferi të Tiranës, në kushte shumë të këqia, në mungesë të plotë të higjenës, ujit dhe energjisë elektrike.

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë vendosi që lidhjen e martesës dhe regjistrimin e fëmijës t'i realizonte njëkohësisht, duke bërë deklarin e lindjes së fëmijës, në momentin e lidhjes së martesës.

Sh. B. e kishte gjëndjen civile në një komunë të rrethit të Shkodrës, ndërsa I. K. në njërën prej Njësive Bashkiake të Tiranës. TLAS i udhëzoi, i ndoqi në të gjitha veprimet e kërkuara, për të realizuar lidhjen e martesës dhe regjistrimin e fëmijës, duke bërë njëkohësisht edhe pagesat e të gjitha shpenzimeve.

1. I. K. u pajis me letërnjoftim elektronik, sipas kërkesave të tanishme, për të mundësuar marrjen e shërbimeve në zyrat e gjëndjes civile.

2. I. K. morri çertifikatë për shpallje martese, pranë Njesisë Bashkiake ku ai figuron i regjis-

truar në Tiranë.

3. I. K. dhe Sh. B. shkuan në zyrën e gjëndjes civile të komunës së Shkodrës, ku Sh. B. ishte e regjistruar. Aty dorëzuan çertifikatën për shpallje martese të I. K. dhe morën një çertifikatë për shpallje martese për Sh. B.

4. I. K. dhe Sh. B. dorëzuan çertifikatën për shpallje martese të Sh. B. në Njësinë Bashkiake të Tiranës, ku është i regjistruar I. K.

5. 10 ditë mbas shpalljes së martesës, Sh. B. shkoi përsëri në zyrën e gjëndjes civile të komunës ku ajo ishte banore dhe morri një çertifikatë për lidhje



martese.

6. I. K. dhe Sh. B. dorëzuan këtë çertifikatë për lidhje martese në zyrën e gjëndjes civile në Njësinë Bashkiake të Tiranës, ku është i regjistruar I. K. Aty u realizua lidhja e martesës dhe u mbajt akti përkatës.

7. Gjatë mbajtjes së Aktit të Martesës, u deklarua edhe lindje e vajzës së tyre dhe u mbajt Akti i saj i Lindjes. Njëkohësisht u mundësua edhe pajisja e Sh. B.

me letërnjoftim elektronik, me mbiemrin e saj mbas martesës. Mbas gjithë këtyre veprimeve, I. K. dhe Sh. B. mundën të realizojnë të gjitha kërkesat e tyre për regjistrimin e vajzës, lidhjen e martesës dhe pajisjen me dokumenta të rregullta identifikimi, duke sjellë kështu normalitet në jetën e tyre.

Elvira Dervishi
Këshilltare e Programit, TLAS



NDRYSHIMET E PROPOZUARA NË LIGJIN “PËR NDIHMËN DHE SHËRBI-MET SHOQËRORE” KON-TRIBUT I DREJTËPËRDRE-JTË I TLAS PËR INDIVIDËT NË NEVOJË

Në zbatim të ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005, filloi reformimi i sistemit dhe programeve të mbrojtjes shoqërore në Shqipëri. Por në procesin e zbatimit të këtij ligji, janë evidentuar edhe disa probleme që kanë kërkuar përmirësimet e nevojshme.

Përmirësimet lidhen me: i) riformulimin e disa termave që kanë të bëjnë me përkufizimet e grupeve përfituese, të ligjit nr. 9355; ii) zgjerimin e grupeve përfituese; iii) administrimin më të mirë të programit të ndihmës ekonomike, sistemit të vlerësimit dhe administrimit të programit të pagesës për aftësi e kufizuar dhe shërbimeve të përkujdesit në nivel qendror ; vi) sigurimin e përfshirjes sociale dhe

mosdiskrimin e disa individëve dhe grupeve në nevojë; v) krijimin e kujdestarisë në familje si shërbim alternativ për fëmijët, si dhe; vi) disa përmirësime që lidhen me rregullat për transferimin e fondeve dhe kompetencave në kuadër të decentralizimit në njësitë e qeverisjes vendore; vii) përmirësim i procesit të vendimarrjes dhe i kontrollit të tij. Në kuadrin e përgjthshëm të balancimit të kompetencave ndërmejt qeverisjes qendrore dhe autonomisë së pushtetit vendorë, për një menaxhim më të saktë të programeve të mbrojtjes shoqërore propozohet që





administratorët shoqëror pranë njësive të qeverisjes vendore, të kenë vartësi direkte të Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Procesi i implementimit të ligjit nr. 9355, evidentoi nevojën e koordinimit dhe harmonizimit të kërkesave të këtij ligji me ligjin "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjike". Për këtë qëllim në projektligj propozohet të shtohen përkufizimet për dy terma: i) një term i vecantë për invalidët paraplegjik. Në kuptim të këtij ligji termi "Paraplegjik" nënkupton çdo person që

vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme dhe termi ii) "Tetraplegjik" nënkupton çdo person, që vuan nga paraliza e katër anësive.

Këto përkufizime mungonin në ligjin bazë dhe në praktikë ka patur vështirësi për të realizuar përfshirjen e këtyrë individëve, në programet sociale. Për këtë arsye në nenin 4 të ligjit bazë, pas pikës 22 shtohen dy përkufizimet e mësipërme.

Po ashtu në projektligj shtohet një përkufizim i ri për viktimat e trafikimit. "Viktimë e dhunes në familje"

Projektligji përcakton edhe përkufizimin për "Punë dhe shërbime", sipas të cilit do të nënkuptohen punët apo shërbimet që ofrohen nga organet e qeverisjes vendore në komunitet, apo punët dhe shërbimet që ofrohen nga programe dhe projekte të organizuar nga institucione dhe struktura të qeverisjes qendrore. Ky përcaktim është bërë në funksion të parashikimeve të reja në projektligj për kushtëzimin e të drejtës së përfitimit të

ndihmës ekonomike me punë dhe shërbime. Zbatimi i këtyre përcaktimeve në ligj, kërkon një koordinim dhe harmonizim të legjislacionit dhe praktikës së programeve dhe projekteve të ofruara nga qeverisja qendrore si psh. programeve të nxitjes së fermerëve shqiptarë, programeve publike për bujqësinë, programeve të shtimit të sipërfaqeve të mbjella, programeve për restaurimet e objekteve arkeologjike, projekteve të pyllëzimeve etj. Për këtë qëllim do të kërkohet në vazhdimësi ndërhyrja e ministrive të linjës, në legjislacionet e fushave përkatëse.

Në praktikë ka lindur nevoja e garantimit të përfshirjes së disa grupeve si përfitues të ndihmës ekonomike. Për këtë qëllim në nenin 5 të ligjit bazë, shtohen tre kategori të reja përfituesish të NE: i) Jetimët të cilët nuk janë në institucione; dhe ii) Viktima e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhërit të mbrojtjes ose të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes."

"Masa mujore e ndihmës ekonomike, kriteret, procedurat, dokumentacioni, kriteret e kush-
tezimit të ndihmës ekonomike dhe kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës ekonomike si dhe mënyra e përlogaritjes së kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike në vlerë, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave". Po ashtu në këtë nen përcaktohet së "Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nxjerr udhëzim për mënyrën e përlogaritjes së masës së ndihmës ekonomike." Ky rregullim do të krijoj mundësinë për të admin-





istruar më mirë skemën e ndihmës ekonomike, për të përcaktuar kohëzgjatjen e familjëve në skeme etj.

Ne p/ligj propozohet që të gjithë grupet e PAK, para &tetraplegjket dhe PAK mendorët, fizike, për të përfituar pagesën e AK të vlerësohen nga një komision i vecante, Komisioni i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KVAK), do të funksionojë pranë Shërbimit Social Shtetëror. Ky permiresim do te bejë te mundur rritjen e cilësis së vlerësimit të aftësisë së kufizuar duke përfshirë dhe element social dhe integrues në

procesin e vlerësimit të PAK.

Në këtë projektligj plotësohen hapësirat e nevojshme ligjore për organizimin e shërbimit të kujdestarisë për fëmijët si një shërbim i ri alternativ. Për këtë arsye në nenin 15, pas pikës 2 shtohen pika 3 & 4 me kete përmbajtje:

“3. Kriteret, dokumentacioni, procedura dhe masën e financimit të shërbimit të kujdestarisë përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standarteve të shërbimeve.”

Në projektligj parashikohen disa përmirësime që synojnë garantimin e përfshirjes dhe mos diskriminimit duke mbështetur me prioritet disa grupe vulnerabël si: fëmijët, gratë e vetmuara, personat me aftësi të kufizuara, fëmijëve të cilët u është hequr e drejta prindërore apo vuajnë dënime të gjata etj.

Për këtë arsye, në nenin 19, pas pikës 3, shtohet pika 4, ku përcaktohen grupet që favorizo-

hen gjatë procesit të llogaritjes për përfitimin e ndihmës ekonomike. Grupet e favorizuara në projektligj përjashtohen nga llogaritja e të ardhurave, kur familjarët në nevojë kanë:

a. Kanë si kryefamiljarë njërin nga fëmijët, për arsye të vdekjes së të dy prindërve,

b. Kanë si kryefamiljarë njërin nga fëmijët, kur njëri prej prindërve është duke vuajtur dënimin me burgim për vepra penale ose kundërvajtje penale me vendim të formës së prerë të gjykatës, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton;

c. Kanë si kryefamiljar njërin nga fëmijët, kur njërit prind i është hequr e drejta prindërore me vendim gjykate, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton;

d. Kanë si kryefamiljar një person me aftësi të kufizuara fizikë e mendorë, paraplegjik dhe tetraplegjik ose invalid punë dhe anëtarët e tjere të familjes së tij janë fëmijë ose persona mbi moshë punë të cilët nuk përfitojnë pension;

e. Kanë si kryefamiljarë nënën, ndërkohë që prindi tjetër



nuk jeton, si dhe kur anëtarët e familjes së tij janë fëmijë ose persona mbi moshë pune të cilët nuk përfitojnë pension;

f. Kanë si kryefamiljar një pjestar të familjes që është mbi moshë pune dhe kur anëtarët e familjes së tij janë fëmijë dhe persona mbi moshë pune, pa varësisht nga të ardhurat nga pensioni apo toka;

g. Janë familje të mbyllura ne shtëpi si pasojë e gjakmarrjes

h. Janë familje të minoritetit rom;

i. Janë familje nën nivelin e varfërisë sipas listës së përcaktuar në aktet nënligjore për-

katëse."

Projektligji ka parashikuar edhe mbështetjen e atyre familjeve ku bashkeshortet janë në proces zgjidhje martesë, duke ju garantuar mbështetje me ndihme ekonomike.

Përmirësim të dukshëm ndryshimet e ligjit synojnë edhe në procesin vendimarrës. Nga përvoja e mëparshme janë zbuluar shumë raste të zbatimit të padrejtë të ligjit nëpërmjet refuzimeve të paligjshme të personave që plotësonin kushtet ligjore të përfitimit. Ndryshimet

synojnë t'a bëjnë këtë proces më të përgjegjshëm dhe më të kontrollueshëm. Këto synime realizohen nëpërmjet një vendimarrje më transparente dhe nëpërmjet mundësisë më efektive të ankimit të personave kërkesat e të cilëve refuzohen. Grupi i ekspertëve të TLAS e konsideron këtë nismë si një kontribut të çmuar për grupet e individëve në nevojë të cilët do të kenë mundësi më të mira për të realizuar të drejtën e tyre kushtetuese për të qenë të mbrojtur nëpërmjet mbështetjes së institucioneve shtetërore në rastet e pamundësisë së tyre për të përballuar nevojat ekonomike dhe sociale.



Grupi i ekspertëve të TLAS



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____ 2010

***“PËR DISA SHTESA DHE NDRY-
SHIME NË LIGJIN NR. 9355, DATË
10.03.2005, “PËR NDIHMËN DHË
SHËRBIMET SHOQËRORE” (I
NDRYSHUAR)”***

Në mbështetje të nenit 78, 83,
pika 1, të Kushtetutës me propoz-
imin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQ-
IPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9355, datë 10.03.2005,
“Për ndihmën dhe shërbimet
shoqërore” (i ndryshuar), bëhen
këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4, bëhen ndryshimet si
më poshtë vijon:

1. Pika 1 riformulohet me për-
mbajtjen si më poshtë vijon:

“Ndihma ekonomike”, është
mbështetja, në para, që u jepet
individëve sipas përcaktimeve
në këtë ligj, ose familjeve në
nevojë.”

2.“Perfitime ne natyre”, është
mbështetja në mallra ushqimore
dhe të përdorimit të përditshëm,
veshmbathje, që u jepen indi-
videve dhe familjeve në nevojë,
sipas përcaktimeve në këtë
ligj.”

2.Pika 7, riformulohet si më
poshtë vijon:

“Administratori i shërbimeve sho-
qërore”, nënkupton nepunesin
civil të njësisë së qeverisjes ven-
dore,
i cili administron shërbimet sho-
qërore në juridiksionin e njësisë.”

3. Shtohet pika 7/1 me përmba-
jtjen si më poshtë vijon:

“Administratori i ndihmes eko-

nomike dhe i pageses per aftesine e kufizuar", nenkupton nepunesin civil qe funksionon pranë njesise se qeverisjes vendore ne varesi te strukturave te Ministrit pergjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, i cili kryen detyrat e ngarkuara nga ky ligj."

3. Shtohen pikat 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30, me përmbytjen si më poshtë vijon:

"23. "Paraplegjik" nenkupton çdo person qe vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme.

24. "Tetraplegjik" nenkupton çdo person, qe vuan nga paraliza e katër anësive:

25. "Fëmijë", nenkupton fëmijën sipas përcaktimit të dhënë në nenin 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

26. "Person mbi moshë pune", nenkupton personin fizik qe në momentin e vlerësimit të kriterëve për përfitimin e ndihmës ekonomike, është mbi moshën e përcaktuar në nenin 92 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

27. "Individ", nenkuptojmë personin fizik qe është: jetim, viktimë e trafikimit, viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare.

28. "Viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare", nenkuptojmë çdo person fizik sipas përkufizimit të dhënë në nenin 3, pika 4, të ligjit nr.9969, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", për të cilin është lëshuar urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje i menjëherëshëm me vendim të gjykatës.

29. "Punë dhe shërbime", nenkuptojmë punët apo shërbimet qe ofrohen nga organet e qeverisjes vendore në komunitet, apo punët dhe shërbimet qe ofrohen nga programe dhe projekte të organizuara nga institucione dhe struktura të qeverisjes qëndrore."

30. "KVAK" nenkupton Komisionin e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, i cili është në administrim të Sherbimit Social Shtetëror.

Neni 2

Neni 5 i ligjit riformulohet si vijon:
“Përfitues të ndihmës ekonomike janë:

1. Familjet në nevojë;
2. Jetimët të cilët nuk janë në institucione;
3. Prindërit më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
4. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhërit të mbrojtjes ose të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes.”

Neni 3

Neni 7 i ligjit riformulohet si vijon:

“Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:

1. Te verbërit, me mungesë të plotë ose të pjesshme të shikimit, të lindur ose të fituar, të cilët janë deklaruar të paaftë për punë, me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë (KMPV).

2. Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen, me vendim të Komisionit të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KVAK), së janë bërë të tillë pavarësisht nga shkaku dhe moshë.

3. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KVAK).

4. Personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune, me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, sipas Statusit të Invalidit të Punës.

5. Ministri përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore dhe Ministri i Shëndetësisë miratojnë rregulloren për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KVAK, si dhe për tipologjinë e sëmundjeve të personave me aftësi të kufizuara.”

Neni 4

Neni 10 i ligjit, riformulohet si vijon:

"1.Ndihma ekonomike është një pagesë e përkohshme, e kushtëzuar, që jepet në formën e një shperblimi mujor, në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

2.Individët, familjet në nevojë kanë të drejtë të marrin përfitime në natyrë, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në Vendim të Këshillit të Ministrave.

3.Kushtëzimi i të drejtës për përfitim të ndihmës ekonomike, bëhet ne rastet kur:

a.personi në moshë pune, anëtar i familjes në nevojë, nuk merr pjesë në punë apo shërbime.

b.fëmijët e famijes në nevojë, nuk ndjekin arsimin e detyrueshëm sipas ligjit nr.7952, date 21.06.1995 "Per arsimin parauniversitar" (i ndryshuar);

c.si dhe në raste të tjera të parashikuara me Vendim të Këshillit

të Ministrave.

4.Masa mujore e ndihmës ekonomike, kriteret, procedurat, dokumentacioni, kohëzgjatja dhe kriteret që duhet të plotësojnë familjet për kushtëzimit të përfitimit të ndihmës ekonomike, si dhe mënyra e përlllogaritjes së kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike në vlerë, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5.Ministri përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, nxjerr udhëzim për mënyrën e përlllogaritjes së masës së ndihmës ekonomike."

Neni 5

Neni 11 i ligjit riformulohet si vijon:

"1.Pagesa për personat me aftësi të kufizuara jepet në formën e një kësti mujor në lekë.

2.Masa e pagesës për këta individë dhe për kujdestarët e tyre, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas nivelit të aftësisë së kufizuar që ata kanë.

3.Përcaktimi i nivelit të aftësisë bëhet nga KVAK sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Ministri përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore dhe Ministri i Shëndetësisë."

Neni 6

Në nenin 15, pas pikës 2, shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me përmbajtjen si më poshtë vijon:

"3.Procedura e sistemimit të fëmijës në familje kujdestare, organizohet dhe mbikqyret nga organet e qeverisjes vendore, të cilat ngrenë pranë tyre komisionet multidisiplinare për vlerësimin paraprak të rasteve. Organizimi dhe funksionimi i komisioneve multidisiplinare, përcaktohet në rregulloren e miratuar nga organet e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8652 date 30.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore "(i ndryshuar).

4. Kriteret, dokumentacioni, pro-

cedura dhe masa e financimit të shërbimit të kujdestarisë përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Ministri përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standarteve të shërbimeve."

Neni 7

Në nenin 18, pika 1 riformulohet si më poshtë vijon:

"Personat juridik publikë dhe personat juridik privat që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, liçensohen sipas rregullave të përcaktuara me ligjin nr.10081, date 23.02.2009 "Per liçensat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar). Kriteret, dokumentacioni dhe procedurat për liçensimin e tyre përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 8

Në nenin 19, pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Përjashtohen nga llogaritja e të ardhurave, sipas pikës 3 të këtij neni familjet në nevojë që:

a. Kanë si kryefamiljarë njërin nga fëmijët, për arsye të vdekjes së të dy prindërve,

b. Kanë si kryefamiljarë njërin nga fëmijët, kur njëri prej prindërve është duke vuajtur dënimin me burgim për vepra penale ose kundërvajtje penale me vendim të formës së prerë të gjykatës, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton;

c. Kanë si kryefamiljarë njërin nga fëmijët, kur njërit prind i është hequr e drejta prindërore me vendim gjykatë, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton;

d. Kanë si kryefamiljar një person me aftësi të kufizuara fizikë e mendorë, paraplegjik dhe tetraplegjik ose invalid punë dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij janë fëmijë ose persona mbi moshë punë, të cilët nuk përfitojnë pension;

e. Kanë si kryefamiljarë nënën, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton, si dhe kur anëtarët e familjës së tij janë fëmijë ose persona mbi moshe punë, të cilët

nuk përfitojnë pension;

f. Kanë si kryefamiljar një pjestar të familjes që është mbi moshë pune dhe kur anëtarët e familjes së tij janë fëmijë dhe persona mbi moshë pune, pa-varësisht nga të ardhurat nga pensioni apo toka;

g. Janë familje të mbyllura në shtëpi si pasojë e gjakmar-rjes;

h. Janë familje që i përkasin minoritetit rom;

i. Janë familje nën nivelin e varfërisë sipas listës së përcaktuar në aktet nënligjore të Keshillit të Ministrave."

Neni 9

Ne nenin 20, bëhen ndryshimet si më poshte vijnë:

1. Pika 2 riformulohet si më poshte vijon:

"Kërkesa për të përfituar ndihme ekonomike bëhet me shkrim nga:

a. kryetari i familjes, ose

b. të dy bashkëshortët, në rastet kur ata janë në proces zgjidhje martese, dhe nuk ka ende ven-

dim gjykate të formes së prerë. Kërkesa nënshkruhet edhe nga të gjithë anëtarët madhorë të saj.

Aplikantët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm tek administratori i ndihmës ekonomike dhe i pagesës për aftësinë e kufizuar, pranë njësisë së qeverisjes vendore. Kriteret dhe procedurat për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

2. Në pikën 3, shprehja "administratori shoqëror", zëvendësohet me shprehjen "administratori i ndihmës ekonomike dhe i pagesës për aftësinë e kufizuar".

3. Në pikën 4 shprehja "administratori shoqëror" zëvendësohet me shprehjen "administratori i shërbimeve shoqërore".

Neni 10

Në nenin 21, pas shprehjes "..... me fondet e buxhetit vendore..", shtohet shprehja " dhe deri në 3 për qind të fondit të kushtëzuar për bllokndihmën ekonomike".

Neni 11

Në nenin 26 bëhen dryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 5, gërma b, fjala "... hartimin", zëvendësohet me fjalën "monitorim".

2. Shtohen gërmat "d" dhe "dh" me këtë përmbajtje:

"d.administron shërbime shoqërore për individët në nivel kombëtar;

dh.administron pagësen e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar.

e. administron vlerësimin e aftësisë së kufizuar, për personat e përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji."

Neni 12

Në nenin 29, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në pikën 6, gërma "a" shprehja "administratori shoqëror", zëvendësohet me shprehjen "administratori i ndihmës ekonomike dhe i pagesës për af-

tësinë e kufizuar".

2. Shfuqizohen pika 29 "7".

shoqëror në juridiksionin e saj."

Neni 13

Shtohet neni 29 /1 me këtë përmbajtje;

" Kryetari i Bashkisë , Njësisë Bashkiake apo Komunës ka këto kompetenca ;

a- Vendos, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e përfitimit ose mospërfitimit të ndihmës ekonomike, si dhe ofrimin e përfitimeve të veçanta të parashikuara në ligj. Masa e përfitimit të ndihmës ekonomike për familjen, e vendosur sipas paragrafit të parë të kësaj pike, caktohet e ndarë për të dy bashkëshortët, të cilët janë në proces zgjidhje martesë dhe nuk kanë ende një vendim të formës së prerë për këtë çështje. Kundër vendimit të refuzimit mund të bëhet ankim i drejtëpërdrejtë në gjykatë."

3. Pika 11, riformulohet si më poshtë vijon:

11. Miratton strukturat e institucioneve në varësi të saj që merren me administrimin dhe realizimin e shërbimeve të përkujdesit

Neni 30, riformulohet si më poshtë vijon:

"1.Për administrimin e shërbimeve shoqërore, pranë qarqeve dhe bashkive/komunave, ngrihen strukturat përkatëse.

2.Për administrimin e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar, pranë Shërbimit Social Shtetëror, ngrihen strukturat përkatëse.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të percaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave"

Neni 14

Neni 31 riformulohet si më poshtë vijon:

"Administratorët e shërbimeve shoqërore në bashki/komuna kanë për detyrë:

a) të identifikojë nevojat

e individëve për shërbime të përkujdesit shoqëror;

b) të ndihmojë në përgatitjen e dokumentacionit, për personat që aplikojnë për përfitimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror;

c) të marrë pjesë në procesin e hartimit të projektvendimit për personat që do të trajtohen me shërbime të përkujdesit shoqëror;

d) të bashkëpunojnë për hartimin e planeve, vendore dhe rajonale, në mbështetje të personave në nevojë;

e) të vlerësojë nevojat e individëve apo familjet që kërkojnë të marrin shërbime shoqërore në përputhje me prioritetet në nivel kombëtar dhe vendor, si dhe të propozojë në strukturën që mbulon çështjet e shërbimeve sociale në njësinë pranë të cilës funksionon, duke patur në konsideratë mundësitë financiare për mbulimin e këtyre shërbimeve,

f) përgatit dokumentacionin dhe propozimet për miratim për ngritjen e shërbimeve shoqërore në këshillin e bashkisë/

komunës;

g) të grumbullojë dhe të hartojë informacione, statistika, dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve të personave që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror;

h) të grumbullojë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe private që veprojnë në territorin e bashkisë/komunës.

Neni 15

Pas nenit 31, shtohet neni 31/1 me përmbajtjen si me poshte vijon:

“Administratorët për ndihmen ekonomike dhe pagesen e afatesise se kufizuar kanë për detyrë:

a) të identifikojnë familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar;

b) të verifikojnë gjendjen shoqërore e ekonomike, të familjeve në nevojë kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që

përfitojnë ndihmë ekonomike;

c) të propozojnë në Këshillin e Bashkisë/ Komunes familjet në nevojë për të përfituar ndihmë ekonomike;

d) të llogarisë dhe përcaktoj masen e ndihmes ekonomike që perfiton familja;

e) të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit, për personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar;

f) të marr pjesë në procesin e hartimit të projektvendimit për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, të listës së personave me aftësi të kufizuar;

g) të hartojnë kërkesën për bllok-ndihme dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar, çdo dymujor për njësinë e pushtetit vendor;

h) të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika, dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar;

Neni 16

Në nenin 35, paragrafi i parë, shprehja "... dhe një herë në dy muaj i transferohen ato në bashki ose komunë", zëvendësohet me shprehjen "...dhe detajon që në fillim të vitit për çdo njësi të qeverisjes vendore."

Neni 17

Në nenin 36, bëhen ndryshimet si me poshte vijon:

1. Në paragrafin e parë, shprehja "...delegohet një herë në katër muaj" zëvendësohet me shprehjen "...transferon... " .
2. Paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 18

Në nenin 38, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në paragrafin e parë, rreshti i parë fjala "...delegohen..", zëvendësohet me shprehjen "... transferohen... ".

Neni 19

Në fund të nenit 40, shtohet shprehja "...dhe ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë."

Neni 20

Neni 41 riformulohet si më poshtë vijon:

"1.Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen sipas ligjit nr.7697, datë 07.04.1993, "Për kundërvajtjet administrative" (i ndryshuar).

2. Çdo shkelje e menaxhimit të fondeve buxhetore që programohen dhe përdoren për, ndihmën ekonomike, pagesën e aftësisë së kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas përcaktimeve të nenit 71, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e

sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë."

Neni 21

Në nenin 43, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

"1.Në rreshtin e dytë pas nenit "11" shtohet neni "15 pika 4";

2.Ngarkohet Ministri përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, të nxjerrë udhëzime në zbatim të nenit 10, pika 5 dhe nenit 15 pika 5."

Neni 22

1.Kudo ku në ligj është përdorur termi "Ministria e Punës, Çështjeve Sociale"/MPCS, zëvendësohet me termin "Ministria përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore".

2.Kudo ku në ligj është përdorur shprehja "administratoret shoqëror në bashki/komunë", zëvendësohet me shprehjen "administratoret shoqëror pranë njësive të qeverisjes vendore".

Neni 23
Dispozite kalimtare

me përjashtim të nenit 3 të këtij ligji, i cili hyn në fuqi më 1 janar 2011.

Efekti financiar për pagat dhe pagesën e kontributeve të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, e administratoreve shoqërore, për vitin 2010, të përballohet nga granti i deleguar në njësitë e qeverisjes vendore nga buxheti qendror, sipas ligjit nr.10190, date 26.11.2009 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit 2010".

K R Y E T A R I

Jozefina Topalli

Neni 24

Komisionimi i personave të përcaktuar në nenin 7, pikat 2 dhe 3 të këtij ligji, do të behet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, deri në fillimin e funksionimit të Komisioneve të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Neni 24

Dispozita të fundit

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren Zyrtare",

SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Nr. 2 / 2010

TLAS

